

## *Social networking and Kosovar political actors*

*Ilire Zajmi\**

### **Abstract**

Social media are changing the nature of mass communication, challenging traditional media. They are used as a powerful platform for sharing and spreading of information, activities, promotion of institutions, of certain interest groups and individuals, but also political actors for different purposes. Sharing and spreading of information through possibilities provided by social media enables to mobilize wider audience in different ways. Politicians are using these opportunities, without any need to share information across journalist or traditional media.

This paper aims to analyse use of social networks as a mean of sharing of information by Kosovan political actors and content shared.

The paper analyses posts of three Kosovo politicians, prime minister Isa Mustafa, president Hashim Thaci and president of Kosovo Assembly Kadri Veseli in their profiles on social networks Facebook and Twitter, over a period of monitoring of fifteen days, during the month of December 2016.

**Keywords:** *Social media, social networking, information, political actors, audience, Facebook, Twitter, traditional media.*

---

\*IlireZajmi, Msc, AAB College, Prishtina. Email: ilire.zajmi@aab-edu.net

# *Rrjetet sociale dhe aktorët politikë kosovarë*

## **Abstrakt**

Mediat sociale po ndryshojnë natyrën e komunikimit masiv, duke demediatizuar median tradicionale. Ato po shfrytëzohen si platforma të fuqishme për plasimin e shpërndarjen dhe informacionit, aktiviteteve, promovimin e institucioneve, grupeve të caktuara të interesit e individëve, por edhe aktorëve politikë për qëllime të ndryshe.

Plasimi dhe shpërndarja e informacionit përmes mundësive që ofrojnë mediat sociale, mundëson mobilizimin e një audience më të gjerë në forma e mënyra të reja. Politikanët po i shfrytëzojnë këto mundësi të ofruara nga rrjetet sociale, pa pasur më nevojë ta plasojnë informacionin përmes gazetarëve apo medias tradicionale.

Ky punim ka për qëllim të analizojë përdorimin e rrjeteve sociale si mjet të shpërndarjes së informacionit nga ana e aktorëve politikë kosovarë dhe përmbajtjet e informacioneve që plasohen. Punimi analizon postimet e tre politikanëve kosovarë, kryeministrit Isa Mustafa, presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli, në profilet e tyre në rrjetet sociale Facebook dhe Twitter, në një periudhë monitorimi prej pesëmbëdhjetë ditësh gjatë muajit dhjetor 2016.

**Fjalët kyç:** *Media sociale, rrjete sociale, informacion, demediatizim, platformë, shpërndarje, aktorë politikë, audiencë, Facebook, Twitter, media tradicionale*

## ***Hyrje***

Mediat sociale janë platforma të shpejta, multimediale dhe ofrojnë dëshmi të informacioneve të bollshme. Ashtu si mediat profesionale edhe ato sociale po luajnë një rol gjithnjë më të madh në informimin e publikut.

Prandaj individë, institucione, personazhe të jetës publike, politikanë, kanë krijuar faqet e tyre në mediat sociale për të komunikuar me audiencën.

Aktorët politikë i adresohen audiencës së targetuar në rrjetet sociale, duke postuar aktivitetin e tyre politik, fotografitë, videot, me qëllim të shfrytëzimit sa më adekuat të hapësirës online, e cila ndiqet me shumë interes nga gazetarët, por edhe qindra -mijëra ndjekës e pëlqyes të profileve të tyre në Facebook apo Twitter.

Këto dy rrjete sociale po përdoren drejtpërdrejt si burim informacioni nga gazetarët, pasi çdo postim i politikanëve shndërrohet në lajm dhe pasqyrohet në edicionet e lajmeve të televizioneve dhe të mediave të tjera.

Ky punim analizon përdorimin e rrjeteve sociale si mjet të shpërndarjes së informacionit nga ana e aktorëve politikë kosovarë dhe përmbajtjet e informacioneve që plasohen përmes postimeve e statuseve.

Punimi analizon postimet e tre aktorëve politikë kosovarë, kryeministrit, presidentit dhe kryeparlamentarit në profilet e tyre në rrjetet sociale, Facebook dhe Twitter, në periudhën 1deri më 15 dhjetor 2016.

Për të zbërthyer postimet është përdorur metoda e analizës së përmbajtjes, në mënyrë që t'u përgjigjemi pyetjeve a përdoren profilet e tre aktorëve politikë për promovimin e pozicioneve të tyre politike, për llojin e imazhit që ata kanë formësuar në sferën

online, si dhe të çfarë natyre janë postimet në faqet e tyre në rrjetet sociale.

Kategorizimi i postimeve të monitoruara është ndarë në tri fusha: të natyrës politike, sociale dhe personale.

### ***Korniza teorike***

Në literaturë ekzistojnë dy teori sa i përket përdorimit të rrjeteve sociale, teoria optimiste dhe ajo pesimiste. Sipas teorisë optimiste rrjetet sociale ofrojnë mundësi për të garuar për pushtet.<sup>1</sup>

Mbështetësit e kësaj teorie<sup>2</sup> mendojnë se në epokën digjitale, jemi dëshmitarë të transformimit të informacionit dhe të audiencës, e cila i përdor ato. Sipas tyre, suksesi global i mediave sociale, ka mundësuar që secili të lidhet drejtpërdrejt me audiencën e tij. Me përdorimin e këtyre platformave aktorët politikanë fitojnë vëmendje dhe njëkohësisht ndërtojnë një marrëdhënie të modelit simetrik ose asimetrik me ndjekësit e tyre.<sup>3</sup>

Teoria pesimiste ndërkaq fajëson mediat sociale për përdorim të promovimit të rrejshëm dhe një pseudo- modernizim të shoqërisë moderne.<sup>4</sup> Studiuesit mendojnë se përfshirja në rrjetet sociale e aktorëve politikë njëkohësisht implikon edhe një angazhim më të madh të audiencës që përthith informacionin e plasuar si dhe ndikon në demokratizimin e konkurrencës politike.

Te përdorimi i mjeteve si Facebook e Twitter ata shohin mënyra të reja intriguese për t'iu shmangur interaksioneve të

---

<sup>1</sup>Sorice, M. (2011), *La comunizazione politica*, fq.101

<sup>2</sup> Levinson, P. (2009). *New New Media*, fq. 139-141

<sup>3</sup> Grunig, James, *Four Models of public relation*, Interactive Media lab Florida

<sup>4</sup>Po aty

strukturuara e të ndërmjetësuar nga mediat tradicionale, si televizioni e radio.<sup>5</sup>

### ***Përdorimi i rrjeteve sociale si platformë informacioni***

Aktualisht rrjetet sociale paraqesin një audiencë të gjerë. Sipas të dhënave të Internet world stats, 3,675,824,813 njerëz në botë përdorin internetin.<sup>6</sup>

Në Kosovë, interneti përdoret prej 76.6 % të popullsisë. Nga kjo shifër 73.3% janë përdorues të facebook-ut.<sup>7</sup>Sipas hulumtimeve të bëra nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit në Kosovë, përdorimi i Facebook-ut është njëri prej katër aktiviteteve që pëlqehet nga bashkësia e përdoruesve kosovarë të internetit.<sup>8</sup> Ndërsa për rrjetin social Twitter hulumtimet tregojnë se përdoret shpesh prej politikanëve dhe personave të famshëm në Kosovë.<sup>9</sup>

#### **Postimet në rrjetin social Facebook**

Postimet në profilet e rrjeteve sociale të kryeministrit Isa Mustafa, presidentit Hashim Thaçi, kryetarit të Kuvendit Kadri Veseli, tregojnë si dhe për çfarë i përdorin ata Facebook-un e Twitter-in.

---

<sup>5</sup> Porter, J. Relationship symmetry in social networks: Why Facebook will go fully asymmetric, February 1, 2001

<sup>6</sup> <http://www.internetworldstats.com/stats.htm/>

<sup>7</sup> <http://stikk.org/publikimet/>

<sup>8</sup> [http://mfa-ks.net/repository/docs/STIKK\\_raport\\_alb\\_2013\\_short\\_web.pdf](http://mfa-ks.net/repository/docs/STIKK_raport_alb_2013_short_web.pdf)

<sup>9</sup> [http://mfa-ks.net/repository/docs/STIKK\\_raport\\_alb\\_2013\\_short\\_web.pdf](http://mfa-ks.net/repository/docs/STIKK_raport_alb_2013_short_web.pdf)

Në kohën e monitorimit, kryeministri Isa Mustafa në faqen e tij zyrtare në Facebook ka pasur 24,877 ndjekës ndërsa ka marrë 24,908 pëlqime.<sup>10</sup> Nga datat 1 deri më 15 dhjetor, ai ka bërë 20 postime. Nga postimet e monitoruara, rezulton se 6 kanë të bëjnë me çështjet vitale, të cilat e shqetësojnë shoqërinë kosovare si, çështja e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, liberalizimi i vizave, lansimi i fushatave për prodhime vendore, kodi telefonik, ndërtimi i murit në veri të Mitrovicës, imazhi i vendit në botë përmes fotografisë. Shtatë postime promovojnë aktivitetet e kryeministrit në ngjarje të ndryshme, katër kanë të bëjnë me aktivitete politike, ndërsa tre lidhur me marrëdhëniet e Kosovës me faktorë ndërkombëtarë.

Më 1 dhjetor, kryeministri shpërndan lajmin për njohjen e Kosovës nga Singapori dhe ratifikimin e marrëveshjes për fondet IPA. Më 2 dhjetor, ai bën tri postime për të njëjtën ngjarje, inaugurimin e urës që lidh Zveçanin dhe Leposaviçin. Postimi i dytë ilustrohet me tetë foto. Më 3 dhjetor kryeministri sqaron audiencën, duke hedhur poshtë raportimet e mediave për pengesat që i ishin bërë për të arritur në ceremoninë e inaugurimit të urës në veri. Më 4 dhjetor, kemi tri postime, dy për zgjedhjet në forumin e gruas së LDK-së. Dy postimet ilustrohen me gjashtë foto. Në postimin e tretë, kryeministri ju adresohet qytetarëve të vendit duke i informuar ata për ngjarjet që e kanë karakterizuar javën. Më 5 dhjetor ai përgëzon qytetarët për zgjedhjet në Drenas. Më 6 dhjetor kemi dy postime, informacioni për rizgjedhjen e kancelares Angela Merkel në krye të CDU-së ilustruar me gjashtë foto, dhe lajmi për përzgjedhjen e një fotografie nga Kosova në mesin e njëqind fotografive më të mira të vitit 2016, nga Revista Time.

Në postimin më 7 dhjetor, ai akuzon kundërshtarët politikë për kauzë të rrejshme, për demarkacionin e kufirit me Malin e zi.

---

<sup>10</sup> <https://web.facebook.com/IsaMustafaKS/?fref=ts>

Më 8 dhjetor, kemi dy postime. Te i pari akuzohen ata që penguan liberalizimin e vizave për Kosovën, në të dytin jepet lajmi për letrën e NATO-s, dërguar Kosovës . Më 9 dhjetor, informacion i ilustruar nga vizita e zhvilluar në maternitetin e dikurshëm në Prishtinë. Më 10 dhjetor, përkujtohet dita ndërkombëtare e të drejtave të njeriut. Më 12 dhjetor, Mustafa përkujton 26 vjetorin e themelimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Më 13 dhjetor, ai bën një postim, për ndërtimin e murit në pjesën veriore të Mitrovicës. Më 15 dhjetor, Mustafa ka bërë dy postime. Në të parin që ilustron me pesë foto lansimi i fushatës për promovimin e qumështit vendor, ndërsa në postimin e dytë ai informon për kodin telefonik ndërkombëtar të Kosovës.

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, në faqen e tij në Facebook, ka 314,527 ndjekës dhe 322, 042 pëlqime.<sup>11</sup> Gjatë periudhës së monitorimit në profilin e tij janë bërë 13 postime.

Te postimet e presidentit Thaçi, rezulton se dominon informacioni nga aktiviteti i tij politik (6) arsimit (2), tema nga lufta (2), kodi telefonik (1) partnerët ndërkombëtarë (1), sundimi i ligjit (1).

Më 1 dhjetor, presidenti informon për betimin e 25 prokurorëve të rinj, të ilustruar me katër foto. Më 3 dhjetor, kemi dy postime. Një informacion për marrjen e çmimit “premio bonifacio” në Anagni të Italisë, të ilustruar me gjashtëmbëdhjetë foto. Ndërsa te postimi i dytë, presidenti fton qytetarët të dalin në zgjedhjet që do të zhvillohen në Drenas. Më 5 dhe 6 dhjetor në postime dominojnë informacionet nga vizita zyrtare në Maltë. Te postimet më 5 dhjetor, dy postime ilustron me 24 foto, ndërsa më 6 dhjetor dy postimet nga takimet në Maltë ilustron me 43 fotografi. Po më 6 dhjetor, me një status, presidenti ka shprehur mendimin e tij lidhur me rezultatet e testit PISA për

---

<sup>11</sup><https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial/>

nxënësit e Kosovës. Më 8 dhjetor, shpërndahet informacioni për letrën e NATO-s për forcimin e bashkëpunimit me Kosovën. Më 12 dhjetor, ai ndan informacionin ilustruar me dy foto nga vizita e tij te familjet e personave të pagjetur, te komuniteti shqiptar dhe serb. Ndërsa te një postim i datës 14 dhjetor ai përkujton heroin Mujë Krasniqi. Më 15 dhjetor, presidenti ka dy postime. Në të parin, jepet lajmi për kodin ndërkombëtar telefonik të Kosovës dhe të dytin për pranimin e Universitetit të Prishtinës në agjencinë universitare të frankofonisë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në rrjetin social Facebook figuron se ka 81,722 ndjekës dhe 82,763 pëlqime.<sup>12</sup> Në periudhën e monitorimit të Facebook-ut, del se Veseli ka bërë 20 postime.

Te postimet e Kadri Veselit, dominon angazhimi i tij politik për zgjedhjet në Drenas (6 postime), reagimi për sulmet terroriste (1), zgjedhjet në Maqedoni (1), promovimi i aktivitetit politik nga vizita në Francë (5), preokupime me çështjet sociale (2), marrëveshja e Dejtonit (1), reagimi për konventën e mbi të drejtat e njeriut (1), ligjet (2), reagimi për luftën në Siri (1).

Në tre nga katër postimet e datës 3 dhjetor të ilustruara me foto, synohet mobilizimi i votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Drenas.<sup>13</sup> Veseli u bën thirrje votuesve të votojnë për kandidatin Ramiz Lladrovci të PDK-së. Në postimin e katërt, Veseli njofton ndjekësit e tij me nënshkrimin e një marrëveshje me USAID. Në postimin e datës 4 dhjetor, ai shpreh angazhimin për personat me aftësi të kufizuara, ilustruar me një foto. Më 5 dhjetor, postime për zgjedhjet në Drenas, ku përgëzohet fitorja e kandidatit të PDK-së, më 6 dhjetor, informacion nga shënimi i ditës së Emirateve të Bashkuara,

---

<sup>12</sup><https://www.facebook.com/kadriveseliofficial/>

<sup>13</sup><https://www.facebook.com/kadriveseliofficial/photos/pcb.687123634796179/687123268129549/?type=3&theater>



ilustruar me dy foto. Në postimet e datave 7 e 10 dominojnë informacionet dhe 16 foto nga vizita zyrtare në Francë. Në këtë datë nuk mungon reagimi për ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ndërsa më 11 dhjetor, Veseli reagon ndaj sulmit terrorist në Stamboll. Më 12 dhjetor, ai përgëzon aktorët politikë në Maqedoni për procesin e zhvilluar zgjedhor. Ndërsa në postimin e dytë ai sërish bën thirrje që të votohet Ramiz Lladrovci, në raundin e dytë të zgjedhjeve që do të zhvillohen më 18 dhjetor. Ky postim ilustron me katër foto. Në postimin më 13 dhjetor, ai adreson një çështje shqetësuese për shoqërinë, ndotjen e ajrit në Prishtinë. Ndërsa më 14 dhjetor, kemi tri postime. Postimi i parë thirrje për të votuar në favor të Ramiz Lladrovci, ilustruar me 10 foto nga tubimet me qytetarë. Te postimi i dytë, ai shpreh mllefin dhe kërkon nga forcat demokratike të botës të mbrojnë Aleppon. Në postimin e tretë, Veseli përkujton 21 vjetorin e nënshkrimit të marrëveshjes së Dejtonit.

Nga analiza e përmbajtjes së postimeve shohim se për çështjet me interes, kanë shpërndarë informacione të tre, si rasti i zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Drenas. Kryeministri e presidenti kanë përçuar mesazhin për mbarëvajtje të procesit, ndërsa kryekuvendari ka përdorur strategjinë e të bërit të fushatës elektorale për kandidatin e partisë së tij. Si Mustafa edhe Thaçi kanë postuar për kodin telefonik të Kosovës, dhe letrën e NATO-s. Sa i përket postimeve të veçanta, vetëm Mustafa ka reaguuar për çështjen e ndërtimit të murit në Mitrovicë, liberalizimin e vizave dhe demarkacionin e kufirit me Malin e Zi. Ndërsa, për dallim prej Mustafës e Thaçit, Veseli ka reaguuar për ndotjen e ajrit në Prishtinë, zgjedhjet në Maqedoni, sulmin terrorist në Stamboll dhe luftën në Siri. Ndërsa, Thaçi është i vetmi që ka reaguuar për testin PISA.

## Postimet në rrjetin social Twitter

Postimet në rrjetin social Twitter të Mustafës, Thaçit e Veselit dallojnë dukshëm nga postimet në Facebook. Pjesërisht për shkak të karakterit dhe përdorimit të hashtagëve, te ky rrjet shohim figura të tjera politike.

Një imazh ndryshe të kryeministrit të Kosovës e ndeshim në postimet e tij në Twitter, ku ai figuron se ka hapur profil nga maji i këtij viti dhe ka 986 ndjekës, e 29 pëlqime.<sup>14</sup>

Gjatë periudhës së monitorimit në Twitter, kryeministri ka bërë 11 postime. Te përmbajtjet e postimeve, Mustafa fokusohet te shpërndarja e informacioneve mbi imazhin e Kosovës dhe perspektivën e saj europiane, marrëveshjen për fondin IPA (1) dhe tri ripostime nga takimet Kosovë - BE për këtë çështje, reagime lidhur me sulmet terroriste në Turqi dhe Kairo (2) të drejtat e njeriut (1) njohjen e Kosovës nga Singapori (1) dhe 6 postimet e tjera kanë të bëjnë me takimet e kryeministrit me aktorë politikë ndërkombëtarë.

Në Twitter, presidenti Hashim Thaçi<sup>15</sup>, figuron se ka 29, 600 ndjekës, ndërsa faqja pëlqehet nga 227 persona. Profili i tij në Twitter është hapur në nëntor të vitit 2011. Nga postimet e monitoruara në këtë periudhë, zbulojmë se presidenti pothuajse ka ndarë të njëjtat informacione me përdoruesit si ato në Facebook. Në 15 postime, presidenti vë fokusin te solidarizimi me vendet që po përjetojnë sulme terroriste si Turqia e Kairo(2), te arsimi (1), kodi telefonik ndërkombëtar i Kosovës (1), vizita dhe pritja në Maltë me dy postime dhe tre ripostime (5)aktiviteti i tij politik (2), ekonomia (1) dhe njohja e Kosovës nga Singapori (2) me një postim dhe një ripostim.

---

<sup>14</sup><https://twitter.com/IsaMustafaKS>

<sup>15</sup><https://twitter.com/HashimThaciRKS>

Në rrjetin Twitter<sup>16</sup>, i pari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka 851 ndjekës e 25 pëlqime. Profili i tij është hapur në prill të këtij viti. Gjatë periudhës së monitorimit të postimeve të tij, shihet se ai ka postuar 4 herë dhe ripostuar 1 herë. Dy postime dhe një ripostim servojnë informacion për vizitën e tij në Francë. Në dy postimet e tjera, ai dënon sulmet në Stamboll dhe Kairo.

Të tre aktorët politikë në Twitter, përveç aktiviteteve politike, kanë reaguar për sulmet terroriste në Turqi e Kairo. Mustafa e Thaçi kanë postuar për njohjen e Kosovës nga Singapori. Ndërsa vetëm Thaçi për kodin telefonik.

### **Facebook vs Twitter**

Nga analiza e përmbajtjeve të postuara, shohim se postimet e tre politikanëve dallojnë. Në Facebook ata kanë shumë ndjekës dhe postimet e tyre fokusohen kryesisht te promovimi i aktiviteteve politike dhe çështjet, të cilat preokupojnë audiencën vendore. Përmbajtja e postimeve në Twitter i adresohet një audiencë tjetër dhe aty fokusi vihet te krijimi i një imazhi të tyre pozitiv, por edhe të Kosovës, vendit që përfaqësojnë.

Sa i përket përdorimit, dëshmohet se më tepër përdorin Facebook-un sesa Twitterin.

Presidenti Thaçi del se ka më shumë ndjekës krahasuar me kryeministrin Mustafa e kryekuvendarin Veseli. Ndërsa ajo që vihet re është postimi i fotografive, sidomos të Thaçi, dhe mungesa e postimit të videove.

Të tre në përgjithësi nuk i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që ofrojnë të dy rrjetet sociale si kanale komunikimi.

---

<sup>16</sup><https://twitter.com/KadriVeseliKS>

## ***Përfundimet***

Postimet në profilet e rrjeteve sociale të kryeministrit, presidentit dhe kryekuvendarit, tregojnë se ato janë një mjet i dobishëm në duar të politikanëve. Facebook, Twitter po përdoret prej tyre, për të promovuar profilin politik online, për të mobilizuar votuesit në zgjedhje, për t'iu kundërvënë kundërshtarëve politikë, për t'iu drejtuar qytetarëve për çështje që lidhen me interesat dhe problemet nëpër të cilat po kalon vendi, si dhe për të ndërtuar një imazh të politikanit, i cili krijon përshtypjen se angazhohet për të zgjidhur problemet që preokupojnë audiencën.

Postimet e analizuara, zbulojnë se pjesa më e madhe e postimeve në të dy rrjetet janë të natyrës politike, një pjesë e konsiderueshme të natyrës sociale, ndërsa gjatë periudhës së monitorimit nuk është bërë asnjë postim i natyrës personale.

## ***Bibliografia***

Bowen, S. A. "Using classic social media cases to distill ethical guidelines for digital engagement". *Journal of Mass Media Ethics*. 28.2013. (119-133.)

Grunig, James, *Four Models of public relation*. Interactive Media lab Florida

Grunig, J. E. *Furnishing the edifice: Ongoing research on public relations as a strategic management function*. *Journal of Public Relations Research*, 18, 2006. (151-176).

Levinson, P. *New New Media*. Boston: Allyn & Bacon Penguin Academics. (Chapter 7, Facebook, Chapter 8, Twitter). 2009.

Porter, J. *Relationship symmetry in social networks: Why Facebook will go fully asymmetric* (Bokardo (2009) (Retrieved February 1, 2011, from <http://bokardo.com/archives/relationship->

symmetry-in-social-networks-why-facebook-will-go-fully-  
asymmetric/)

Sorice, M. *La comunicazione politica*. Carocci. Roma:2011.

Ueb faqe

<http://www.internetworldstats.com/stats.html/> herën e  
fundit parë më 17 dhjetor 2016

[http://stikk.org/publikimet/herë e fundit parë më 17  
dhjetor 2016](http://stikk.org/publikimet/herë_e_fundit_parë_më_17_dhjetor_2016)

[http://mfa-ks.net/repository/docs/STIKK\\_raport\\_alb\\_  
2013\\_short\\_web.pdf](http://mfa-ks.net/repository/docs/STIKK_raport_alb_2013_short_web.pdf)

<https://web.facebook.com/IsaMustafaKS/?fref=ts/> herën e  
fundit parëmë 15 dhjetor 2016

<https://twitter.com/IsaMustafaKS>, herën e fundit parë më 16  
dhjetor 2016

<https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial/> herën e  
fundit parë më 15 dhjetor 2016

<https://web.facebook.com/kadriveseliofficial/>herën e  
fundit parë më 16 dhjetor 2016

<https://twitter.com/HashimThaciRKS/> herën e fundit parë  
më 15 dhjetor 2016

<https://twitter.com/KadriVeseliKS/> herën e fundit parë më  
15 dhjetor 2016